

**NË EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda,** sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi dhe anetrave te trupit gjykues, Berat Spahiu dhe Aziz Shaqiri, ne ceshtjen penale te te pandehurve, Sh. B. nga Gj., rruga "...” numer ..., per shkak te veprave penale, zbulimi I fshehtesis zyrtare nga neni 347 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te, shperdorimi i pozites zyrtare ose autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 te KPPK-se, cenimi i fshehtesis se korrespondences dhe bazave te te dhenave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 e 1 te KPPK-se, të cilin e mbron sipas autorizimit av. Sh. P. nga Gj. dhe A. A., nga Gj. , lagja "...”, rruga "...”, per shkak te vepres penale cenim i fshehtesis se korrespondences dhe bazave te te dhenave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPPK-se, e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, PP/I.nr.255/14, e dt. 19.06.2015, e pas mbajtjes e shqyrtimit publik gjyqesor me dt. 31.05.2016, shpalle ndersa me 20.06.2016 perpilon:

**AKTGJYKIM**

**E akuzuara Sh. B.** nga babai I. dhe e ema H., e lindur T., e lindur me dt. ..., ne Gj., ku edhe tani jeton, Rr. ‘...’ nr ..., ka te kryer fakultetin ..., e martuar, nene e ... femive, e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e R. te Kosoves, e pa denuar dhe as nen hetime.

**-e ne baze te nenit** 364 paragrafi 1 e lidhur me nenparagrafin 1.3, nenit 454 paragrafi 1 dhe nenit 463 paragrafi 3 te KPPRK-se.

**LIROHET NGA AKUZA****I.****1.Sepse nuk eshte vertetuar se:**

E akuzuara Sh. B. ne muajin ... te vitit 2012, në cilesin e personit zyrtare pa autorizim i ka vene ne dispozicion personit tjetër informaten qe përben fshehtesi zyrtare, me qellim te përfitim personal ose me qëllim të publikimit apo shfrytëzimit të informacionit jashtë Republikës së Kosovës, në atë mënyre që tabulatet e mesazheve të siguruar në lenden PPN.../2012 permes masave te fshehta, ia ka dhene G. B., e të cilat më pas i njejt i ia përcjell personit të paautorizuar, ne rastin konkret të pandehurit A. A..

**-Me cka kishte me kryer vepren penale, zbulimi i fshehtesive zyrtare nga neni 347 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK-se.**

**2.Nuk eshte vertetu se:**

E akuzuara Sh. B. në muajin ... 2012, në cilësin e personit zyrtar, ka shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, duke i tejkaluar kompetencat e saja me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm të dobis pasurore per vehte ose per tjetrin, apo te shkaktimit të dëmit personit

tjetër të dëmtuares XH. K., në atë mënyre që tabulatet e mesazheve të nxjerra përmes masave të fshehta nga numri i saj i tel. ..., në lëndën PPN.../2012, e të cilat nuk kanë pas fare të bëjnë me rastin konkret, ia jep Av. G. B., i cili si mbrojtës i të pandehurit A. A. ia jep të njëjtit tabulatet e mesazheve (sms) në kompensim prej 250 euro, me c'rast duke e dëmtuar dhe cenuar rendin privatesin e të dëmtuares.

**-Me cka kishte me kryer veprën penale, shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 të KPPK-së.**

### **3. Nuk është vertetë se:**

**E akuzuara Sh. B.** në muajin ... të vitit 2012, në cilësinë e personit zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, me qëllim të përfitimit të dobis pasurore për vetë ose për personin tjetër apo për të shkaktuar dëm personit tjetër, me dashje pa autorizim, ka cenuar fshehtësinë e të dhënave të siguruar përmes masave të fshehta, edhe atë tabulatet e mesazheve të nxjerra nga numri telefonik i të dëmtuares XH. K., duke ia dhënë të njëjtat G. B. me qëllim të përdorimit të këtyre tabulatëve në një vendim gjyqësor, edhe pse e njëjta e ka ditur se këto prova nuk kanë të bëjnë fare me çështjen konkrete.

**-Me cka kishte me kryer veprën penale, Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të dhënave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 e 1 të KPPK-së.**

**Shpenzimet** lidhur me këto qeshtje penale mbesin në barre të mjeteve buxhetore të Kshillit gjyqësor të Kosovës.

**E dëmtuara XH. K.**, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në contest civil.

## **II.**

**Ndaj të akuzuarit A. A.**, nga babai A. dhe nena T., e lindur F., i lindur me ..., në f. M. K. Gj., tani jeton në Lagja ... rr. "...", me profesion elektroinstalues, i martuar, baba i ... femive, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës, i pa denuar me heret dhe as nën hetim.

E conform nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3, 454 paragrafi 1 dhe 463 paragrafi 3 të KPPK-së, **per shkak të parashkrimit relative të ndjekjes penale.**

### **REFUZOHET AKUZA**

I pandehur A. A., nga muaji ... i vitit 2012 e deri me ... të vitit 2014 në Gj., me dashje ka cenuar fshehtësinë e të dhënave-dokumentave të mbyllura, me qëllim të shkaktimit të dëmit personit tjetër, në atë mënyre që ka pranuar nga avokati i tij mbrojtës G. B., tabulate të mesazheve me përmbajtje të privatësisë së të dëmtuares XH. K., të cilat i njëjti pa autorizim i hapë dhe ia dorëzon personit tjetër-vëllait dhe axhes së të dëmtuares me leter rekomandim në Z., e po ashtu të njëjtat i dërgon edhe në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në atë mënyre që të përdoren si provë në çështjen C.nr.../13, duke e dëmtuar dhe cenuar kështu rendin integritetin e të dëmtuares.

**-Me cka kishte me kryer veprën penale, Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të dhënave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPPK-së.**

**-Shpenzimet e procedurës bien në barre të mjeteve buxhetore të Kshillit Gjyqësor të Kosovës.**

**E demtuara XH. K.**, per realizimin e kerkeses pasurore juridike, udhezohet ne contest civil.

## **A R S Y E T I M**

**Prokuroria Themelore DKR ne Gjilan**, me dt. 19.06.2015 ka ngritur aktakuzen PP.I.nr.255/14, ndaj te akuzuarve: Sh. B.per shkak të veprave penale, zbulimi i fshehtesis zyrtare nga neni 347 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se, shperdorimi i pozites zyrtare ose autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 te KPRK-se, cenimi i fshehtesis se korrespondences dhe bazave te te dhenave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 e 1 te KPRK-se, dhe A. A. , per shkak te vepres penale cenim i fshehtesis se korrespondences dhe bazave te te dhenave kompjuterike, nga neni 168 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se dhe ka kerkuar që pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor, te njejtiti ti shpalle fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

Ne fillim te shqyrtimit gjyqsor, trupi gjykues ka vendosur qe shqyrtimi gjyqsor te jet publik, sipas kerkeses se perfaqsesit të të demtuares XH. K., Av. N. D., e me pelqimin e mbrojtseve te te akuzuarve.

**Te akuzuarit Sh. B.dhe A. A. nuk e kan pranuar fajesine per veprat penale qe u vehen ne barre.**

Gjat fjales hyrse te paleve ne procedure, eshte bere nji leshim nga ana e trupit gjykues, ku ne fjalen hyrse nuk ishte present e demtuara XH. K.. Mirpo pas vrejtejeve te perfaqsesit te te demtuares, trupi gjykues ka marre aktvendim procedural, ka ftuar te demtuaren dhe te njejtetes I'a ka lexuar ne tersi fjalet hyrse te palve ne procedure.

Procedura e provave:

**E demtuara XH. K.**, ka deklaruar se tani nuk jeton ne bashksi martesore me te pandehurin A., tani jan te shkurorzar dhe jetojn ndaras. A. nuk ka pas kanosje nga familjaret e saje. I kan dy femije te perbashket, te cilet I jan besuar asaj. Nuk eshte e informuar se telefoni I saje ka qen I pergjuar dhe jan nxjerre SMS me masa te fshehta nga Sh. B.SMS-te jan perdor si prova ne procedure civile per besimin e femijve. Nuk e din se kush I ka dorzuar ne Gjykate, por ish bashkshorti I saje I ka kerkuar perms perfaqsesit te tij Av. T. B.. Tabulatet e SMS-ve jan shperndare edhe ne Z., perms postes, I jan derguar vllaut te saje P. K.dhe axes R. K. te cilet jetojn ne Z.. Keto tabulate I jan ardhur edhe ne shtepi perms dy njerzve I. N.dhe nji tjetet me emrin H., mbiemrin nuk ia din. Kur ka pas kontakt me femije ne QPS ne Gjakove, non stop I eshte thene keto fjale nga ish bashkshorti, se SMS-te I ka siguruar nga Av. T. B. dhe nga nji tjetet Avokat me emrin G. B.. Tabulatet e SMS-ve avokatet ne fjale I kan marre ne Prokurori nga Sh. B.kete informate e ka nga ish bashkshorti, jo nji here por shume here. Nuk ka njohuri se A.i ka paguar per kta SMS.

A.in e ka perfaqsu Av. G. B.per qeshtjen penale te kanosjes. Axha i saje Z. K.ka qen ne prokurori dhe nji kusheri R. K.. Prokuroria I ka shpallur te pa fajshem dy agjallaret e saje.

Per here te pare per SMS-te ka degjuar ne vitin 2012.

Proceduren per shkurorzim e ka inicuar A. dhe gjithqka ka perfunduar sa I perket A.

**Deshmitari T. B.**, deklaroj se e ka perfaqesuar tani te akuzuarin A. A., ne Gjykatën e Qarkut ne Peje , lidhur me kontestin per shkurorzim dhe besim te femive.

Në procedur te shkalles se pare, ne Gjykatën e Qarkut ne Peje kto tabulate te sms-ve, nuk jane perdor si prova .

Gjykata e Qarkut të Pejës e kishte aprovuar shkëmbimin, mirëpo femijet ia kishte besuar tani të demtueses, ku pala paditese dhe farefisja I tij nuk ishin të kënaqur me vendimin dhe kanë shprehur paknaqësi me punën e tij, sa I përket besimit të femijëve .

Njëher këto vendime e ka atakuar me ankesë dhe pastaj me revizion.

Pas marrjes së vendimit nga Gjykatat, A. dhe familja e tij I kanë thënë se janë në rrezik sipas adeteve shqiptare, dhe janë të detyruar me iu argumentu familjes, se ka shkelje të besnikrisë bashkshortore.

Në nderkohë ka qenë një procedurë penale me denoncim në polici, A. ka kërkuar nga ky qe të angazhohet në procedurë, por ky nuk ka pranuar.

Të mëtej I jashtëzakonshëm-revizioni, këto tabulate të sms-ve janë përdorur si prova, por kur ja ka sjellë A. ky i ka mbyllur në zarf dhe mbi zarf ka shkruar me dorën e tij, se këto mund të hapen vetëm nga kolegji I gjykatës, për shkak të ruajtjes së privatesisë.

Pas kësaj, tani I akuzuari A. për në procedurë penale I ka thënë se e ka angazhuar avokatin G. K. nga P.

Kur ka filluar kjo procedurë rreth kësaj çështjeje penale, ka marrë vesh të prokurori se qenka i angazhuar avokati G. B. e jo G. K..

Nga A. ka mesuar se avokatin G. B., e ka paguar 300.00 (treqind) euro, për sigurimin e tabulateve të sms-ve.

A. nuk i ka treguar se nga i ka siguruar ato dhe vetë ai i ka thënë se nuk e di kush i ka siguruar.

Në një seancë të ndërmjetimit, ka marrë pjesë dhe kanë komunikuar publikisht me të demtuesen, nëpërmjet të autorizuarit të saj, por është e mundur edhe drejtpërdrejt të këte ndëru ndonjë fjalë gjatë procedurës.

Absolutisht nuk i ka thënë të demtueses, se heq dorë nga femijet, se i ka tabulatet dhe bëhesh hor me to.

Gjatë kohës sa e ka përfaqësuar A. në kontesë civile, ky I ka thënë se është i kërcënuar nga familja e tani të demtueses.

**Dëshmitarja E. T.**, në deklaratën e saj ka thënë se është administratore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, që nga viti 2004. Detyrat e saja të punës janë ..., ndërsa me lende nuk ka të bëjë fare.

Nuk ka njohuri për lenden PNR. 5/11, sepse nuk merret me lende.

Në momentin kur vin lendet ato regjistruhen në liber dhe shpërndahen të prokurorët.

Nuk e ka ditur se me këte lende është e ngarkuar Sh. B. dhe për këte gjë ka mesuar nga mediat.

Edhe për rastin e nxjerrjes së tabulateve në opinion, ka ndërguar nga mediat.

Më vonë ka biseduar me Sh. B., se nga kanë mundur të rrjedhn këto tabulate në opinion por nuk e kanë zbuluar. Gjithashtu nuk e din se a ka përfunduar, kjo lende a është aktive. Lendet e përfunduara dërgohen në arkiv dhe vendosen në sirtar.

**Më kërkesën e gj. I. H.** dhe me urdheres të ...s Sh. B. lenden penale PPN.../12 I'a ka dorëzuar gjyqtarës I. H. për shikim të shkësive, ku dy zarfa me sms kanë qenë të mbyllur, lenden e ka marrë nga zyra e arkives dhe e ka marrë nga vetë gj. I. H..

Sa e din kjo, lenda e përmendur më lartë është dërguar edhe në Prokurorinë Themelore në Gjilan kur ka filluar ky rast.

**Dëshmitarja S. G.**, në prokurori punon prej vitit 1991 e gjer më tani. Aty punon si ... e ... duke përfshirë edhe vitin 2012. Me lendet SEK (secret) kanë qenë të ngarkuar prokurorët dhe kryeprokurorja kjo nuk merret me to. Vetëm pasi ka dalur në televizion kjo ka ndërguar për këto tabulate. Nuk ka ndodhur asnjëherë që kryeprokuroja Sh. B. të na i këte marrë qelset e shkrimores për më marrë ndonjë shkësë.

**Dëshmitarja P. K.**, deklaroj se në prokurorinë themelore në Gjakovë ka detyrën e .... Nuk mund të mbajmë mend lendet që dorëzohen në arkivë e as lenden që e përmend prokurori. Nuk

ka pas njohuri per tabulatet e sms-ve, por ka ndegjuar nepermjet mediave, keto sms nuk kane dalur nga zyra ku ajo punon. Nuk e di se cili prokuror ka qene i angazhuar me kete lend. Lenda gjendet ne arkive sepse ajo eshte e perfunduar.

**Deshmitari G. B.**, ka kerkuar qe te jete deshmitar i prveligjuar per shkak se ka qene avokat i tani te akuzuarit A. A. .

Gjykata me nje aktvendim procedural, e konform nenit 127 paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 te KPK-së, e ka aprovu propozimin e deshmitarit G. B., qe i njejti mos te deshmoj perkitazi me te pandehurin A. A.. Ndaj ketij aktvendimi avokati N. D. nuk ka pasur vëretje. Ne deklaraten e tij deshmitari G. B. ka thene se deshmitaret :E. T., S. G., N. L. dhe P. K. i njej si fetyra, por nuk e di qe ti veqoj secilen veq e veq. Gjithashtu nuk e din saketsisht se cka punojn ne prokurori, por e din qe punojn ne shkrimore te Prokuroris Themelore ne Gjakove, ndersa ateher ka qene Prokuroria Komunale ne Gjakove. Ka pas autorizim per ta perfaqesu A. A., ne Prokurorin Komunale ne Gjakove.

Trupi Gjykues ne kete faze te procedure i'a ka ndalu pyetjet prokurorit te shtetit, sepse ato kane pas te bejne drejtperdrejt me te akuzuarin A. A., per te cilin deshmitari eshte prejashtu nga deshmia.

Pas kesaj situate avokati N. D., i pakanqur me rrjedhjen e procedures ka kerkuar nderprerjen e séances, gje te cilen e ka refuzu trupi gjykues.

Pas ketij vendimi te trupit gjykues, avokati N. D.- perfaqesuesi i te demtuares ka kerkuar perjashtimin komplet te Gjykates Themelore ne Gjilan dhe se bashku me perfaqesuesin tjetër avokatin E. B. dhe te demtuaren XH. K., ne meny demonstrative e kane leshuar senacen.

Me aktvendimin e kryetarit te Gjykates Themelore ne Gjilan PNNR 1896/16 te dates 28.04.2016, është hudhur si e pa lejuar, kërkesa e perfaqesuesit te te demtuarit av .N. D., per prejashtimin e te gjithë gjyqtareve te Gjykates Themelore ne Gjilan.

Me aktvendimin e gjykates se Apelit te Kosoves PNNR 346/2016 te dates 16.05.2016, kjo gjykate ka refuzuar si te pabazuar kerkesen e perfaqesuesit se pales se demtuar XH. K., avokatit N. D., për prejashtimin e kryetarit te Gjykates Themelore ne Gjilan PKR.nr 156/15

Avokati N. D.perseri me daten 30.05.2016, me nje kerkes ka kerkuar prejashtimin e kryetarit te kesaj gjykate z.Zyhdi Haziri, te cilin turpi gjykues e ka hudhe kete kerkes si te palejuar, me arsyetim se Gjykata e Apelit te Kosoves ka vendos njeher per kete qeshtje me aktvendimin PNR 346 /16, te dates 16.05.2016.

Ne seancen e dates 31.05.2016, ne te cilen nuk kane marre pjese e demtuara XH. K. dhe perfaqesuesit e saje avokatet N. D.dhe E. B., te cilet ishin ftuar ne meny te rregullt mosardhjen e tyre nuk e kane arsyetu, e ne te cilen seance është vazhduar me proceduren e provave, me vazhdimin e marrjes ne pyetje te deshmitarit G. B., per shkak te nderprejes se séances se kaluar.

Ne pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtjesiti te te akuzuarit Sh. B.avokatit Sh. P., deshmitarit G. B., trupi gjykues i ka ndalu pergjigjet e deshmitarit ne nje varg pytyesh, per shkak se ato kane qene pytye te drejtperdrejta, ndersa deshmitari ka qen I propozuar nga Prokuroria.

Kjo ka ndodhur edhe me pyetjet e te akuzuares Sh. B.dhe mbrojtjesit te te akuzuarit A. A., ndersa i akuzuari A. A. nuk ka pasur pytye per deshmitarin.

Ne pytyet e serishme te prokurorit te shtetit deshmitari G. B. perseri është ndaluar te pergjigjet ne pytyet qe kane te bejne me te akuzuarin A. A..

Ne pyetjet e metutjeshme te prokurorit te shtetit deshmitari G. B. ka thene, se me te akuzuaren Sh. B. eshte ne raporte kolegiale, sepse me te eshte njohur gjate kohes sa ka qene kryeprokuror ne Prokurori ne Peje.

**Deshmitarja N. L.**, ka deklaruar se punon si referente ne prokurorin themelore ne Gjakove. Prej vitit 2013 eshte ... e krimeve te renda . Kur e pranojn nje lende, e vendsoin vulen e pranimit. Nese lenda eshte e mbyllur, vulen e pranimit e vendosin ne zarf dhe e dorzojne te prokurori i qeshtjes. Regjistrat dhe lendet sekrete i ka mbajur kryeprokurori. Per lenden PPN .nr .../12, ka marre vesh nepremjet mjeteve te informimit. Nuk e din se kush e ka pasur kete lend nga prokurorët. Nuk e din se a e ka pasur dikush tjeter kete lend. Gjithashtu nuk e din dhe nuk ka pasur raste, qe dikush tjeter ta kete hapur lenden te cilen e ka kryer nje prokuror.

**Me kerkesen e deshmitarit K. G., gjykata e ka lejuar që mos të pergjigjet ne pyjet e caktuara, që kane te bejnë me autorin e publikimit apo burimin e informatës.**

Deshmitari K. G. ka deklaruar, se që nga momenti që ka marre informacione, ka konsultuar të gjitha burimet, përfshir ...n- tani te akuzaren, te akuzarin A. A. dhe te demtuaren XH. K.. Si burim të informatave i ka shfrytëzuar edhe avokatet T. B. dhe G. B., por ky I fundit nuk ka dashur të jap intervistë.

Me kryerprokuroren jane zhvilluar dy intervista me interval kohore prej dy-tri jave dhe dy intervista me te demtuaren Xh.. Kane kontaktuar edhe Posten e Kosoves, valen per me pa mundesin nese nga ata kane mundur me rrjedh tabulatet. Përgjigja e tyre ka qene negative.

Arsyja pse I kane zhvilluar dy intervista me ...n, është se kryeprokuroja nuk ka mundur me ju dhene pergjigje te sakt, se nga kane mundur me rrejdhun tabulatet, per kete arsyje jane kthyer per se dyti me pyt prokuroren, nese ka arrit me zbulu se nga kane rrjedh tabulatet.

Kane marre premtimin nga prokuroja se do te beje nje hetim lidhur me rastin. Kur kane shkuar heren e dyte per intervist kryeprokuroreja lenden e ka pasur ne tavolin. Kur e kemi pytur ...n se si ka mbrri Avokati G. B. me i marr tabulatet nga lenda, ...s nuk I është kujtuar se G. B. eshte avokat ne ate lend, mirpo gjate shfletimit te lendes kryeprokuroreja e ka pare autorizimin ne lende.

Kryeprokuroja ka pranuar se është marrë me nje lend per kanosje.

Para emisionit është intervistaur edhe tani I akuzuari A.. Aneksa fillestare e tij ka qene per qeshtjen e besimit te femive. Fillimisht A.i nuk ka pranuar me fol, mirpo ekipit tone i ka treguar se i ka tabulatet.

Pastaj une edhe nje herë jam takuar me A. ne Gj. dhe pas gjysme ore bisede, A. ka vendos me hy ne interviste. Gjate intervistimit e ka pranaur se I ka tabulatet dhe te njejtat I ka mabjtur mbi tavolin gjate kohes se intervisimit. **Përgjigja e tije ka qene se tabulatet I ka siguruar avokati G. B. te kryeprokuroroja Sh. B.**

Për këtë angazhim A. ka thene se e ka paguar avokatin 250 euro.

Ne seanc gjyqesore jane shikuar –degjuar edhe dy CD nga Birn.

Ne reprodukimin e cd numer 2 shihet –degjohet tani i akuzuari A. A. duke deklaruar se avokati T. B. i ka kerkuar tabulatet nga prokurorja Sh. B.mirpo e njejtat nuk i'a ka dhene. I ka lyp edhe vet dy-tri herë keto tabulate-mesazhe por nuk i'a ka dhene Sh. B.per kete A. ka ushtruar nje ankes te kryeprokurori i shtetit dhe ka marre pergjigje se mesazhet nuk mundet me i marre deri sa lenda të shkoj ne gjykate. Edhe Sh. B. ka thene se nuk mundesh me i marre keto mesazhe po vetem ne seanc gjyqesore. Keto mesazhe i ka nxjerr G. sepse T. B. nuk ia kane dhene. Keto mesazhe i'a ka derguar vellaut te saj dhe mixhes se saj ne Z. si prova matriale.

Gjate reprodukimit te cd numer 1, shifet Sh. B.duke dhene intervist, e cila deklaronte se lenden qe e ka përpara posa e ka marre nga Gjykata Themelore ne Gjakove, per shkak te nje kontesti civil.

Kryeprokurorja - tani e akuzuara deklaroi se nuk ia ka dhene tabulatet –sms askujt. E akuzuara Sh. B. edhe ne kete intervist nuk e mohon faktin se e ka pasur kete lend, mirpo te njejten pas perfundimit e ka derguar ne shkrimore dhe është e vertet se nje autorizim te avokatit G. B., tani e ka pare ne shkresat e lendes. Nuk ka shance qe prej institucionit tone te kene dalur keto sms – tabulate e as nga punetoret e saj. Nga biseda qe e ka pasur, me avokatin e pales G. B., i njejti i ka thene se eshte qështje e tij se nga i ka siguruar keto sms-tabulate.

Leximi I shkresave:

Kerkesa e te demtuares drejtuar XH. K.t, drejtuar ...s Sh. B. e dates ... .2014, me te cilen e demtuara e njofton Sh. B. mbi emisinin e BIRNIT dhe kerkon skjarime se si kanë mundur te dalin ne opinjon keto mesazhe.

Parashtresa e dates ... .2014 nga e demtuara XH. K. drejtuar Prokurorise Themelore ne Gjilan-DKR, me te cilen e ka njoftuar prokurorine se eshte ftuar nga e njejta, duke i paraqitur edhe propozimet per nxjerrjen e provave, duke dhene skjarime per rastin.

Kundershtimi i dates ... .2012, kunder aktvendimit te Gjykates Komunale ne Gjakove, E.nr.../12 I dates ... .2012, i parashtruar nga tani i akuzuari A. A..

Parashtresa e provave te paditsit, dergesa e provave e dates ... .2013, fotografit sipas te cilave deshmohet dergimin postar jasht vendit ne Z. nga i pandehuri A. A., derguar P. K. .

Autorizimi i Av. G. B. i dates ... .2012, sipas te cilit A. A. emron si perfaqses te tij Av. G. B. ne procedure penale.

Regjistri “ Sec” i vitit 2012, i ish prokuroris Komunale ne Gjakove per tere vitin 2012, ku shifet se lenda PP.I.nr. .../2012 nuk figuron ne kete regjister.

Shenim Zyrtar PP.nr. .../2012 I dates ... .2014, sipas te cilit, Prokuroria Themelore ne Gjakove, Kryeprokurorja Sh. B. e autorizon Policine per veprime hetimore ndaj te dyshuarit A. A., lidhur me shperndarjen e SMS-Tabulateve.

Urdhresa PP.nr.../12 e dates ... .2012 e nenshkruar nga Prokurorja Sh. B. per venjen ne pergjim te nr. telefonik ... .

Gjykata ka refuzuar propozimin e Mbrojtsit te te akuzuarit A. A., Av. S. R., per administrimin e disa provave material siq jan: Paraqitja e kercnimit per kanosje nga tani I akuzuari A. A., adresuar PK ne Gjakove date ... .2012, propozimakuzes nga I njejti drejtuar Prokurorise Komunale ne Gjakove ndaj te pandehurve Z. K. dhe R. K. me date ... .2012 si dhe kerkesen nga Prokuroria Komunale ne Gjakove me shenjen PPN nr..../2011 te dates ... .2011, si te pa rendsishme per zbardhjen e qeshtjes.

Mbrojtja e te akuzuarve:

E akuzuara Sh. B. ka deklaruar se ne Prokurroin Themelore ne Gjakove, perkatesisht ne Prokurorin Komunale ne Gjakove, ka filluar te punoj prej ... 2000, ne cilesi te prokurores e deri me ... .2010, kur është emeruar ... e Prokuroris Komunale ne Gjakove. Prej ... te vitit 2013 është ne poziten e kryprokurorit ne Prokurorin Themelore ne Gjakove, e njejta nuk i ka pranuar veprat penale qe i vihen ne barre, duke theksuar se informaten qe e ka pas ne dispozicion sms, t’ia kete dhene personit tjetër av, G. B.. Nuk e mohon faktin se ka pasur ne pune këte lend, i ka ndermarr veprimet hetimore dhe kur ka konstatuar se nuk ka te bej me kanosje, per

te cilen tere kohen ka pretendu tani i akuzuari A. A.. Me daten ... .2013 kam marre nje urgjenc nga paditesi privat A. A., ne te cilen është thene se është rrezikuar me kanosje dhe se elementet e kanosjes nderlidhen me telefonin numer ... . Si prokurore e lendes ka kerkuar veprimet procedural ne drejtim te vertetimit te fakteve qe gjenden ne telefonin e apostrofuuar dhe ka nxjerrur nje urdheres me te cilen ka kerkuar nga zyra ligjore sms-te per peridhen kohore ... .2011 e deri me ... .2011. Pas marrjes se ketyre mesazheve, ka vrejt se keto mesazhe nuk kane fare te bejn me kanosje, ashtu qe i ka nderpre veprimet e metutjeshme, me faktin se e ka hudhe padin private, pasi qe nuk ka gjetur prova per kanosje.

E njejta ka deklaruar se tere kohen akuzohet per vepren penale nga neni 339 paragrafi 1 te KPK-se kinse të kryer ne muajin qershor te viti 2012 edhe pse kjo veper faktikisht po te egzistone qe ne start ka qene e parashkruar, pasi kane kaluar me teper se dy vite ne momentin e fillimit te hetimeve.

Per dispozitivin e trete te aktakuzes ku akuzohet per vepren nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 te KPK-së, ne veprimet e saja nuk ka elemnte te vepres penale, sepse kjo veper sipas kodit penal kryhet ne leter te mbyllur, perkatesisht, hapja e letres se mbyllur telegrafit, ose dokumenteve tjera, te cilen gje nuk e ka bere, nuk ka bere nderhyrje ne sistemin kompjuterik. Pjesen e pare mund ta kryejn zyrtaret e postes- postieret te cilet i kane letrat e personave te ndryshem dhe mund ti hapin dhe keqperdorin, ndersa ne rastin e dyte nderhyrje ne sistemin kompjuterik e kryejn hakeret. Ajo nuk ka bere thyerjen e asnje pasvordi e as nderhyrjen ne te dhenat kompjuterike. Për momentin është e suspenduar ne pritje te një vendimi te Gjykates per këtë qështje.

Eshte e verete se e ka pasur ne pune lenden penale PP. .../12, e ka perfuduar dhe e ka dorezuar ne shkrimotre te PTH ne Gjakove. Kete lende pas perfundimit e ka pranuar N. L. refrente me daten ... .2012. Nga shkrimorja pasi te regjistrohet, lenda dergohet ne arhiv.

Ne zyren e saj nuk ka qene asnjeher avokati G. B., por vetem ne rastin kur e ka thir vet, pas rastit qe ka ndodh per skjarim, se ku i ka marre tabulatet.

Me dijen e saj keto tabulate nuk jane dal nga prokuroria dhe nese dikush e ka bere, e ka bere ne menyre te fsheht.

Lenda PPI 5/12 ka shkuar ne gjykatën themelore ne Gjakove ne baze te kerkeses se gjykates , me kete rast kjo nuk eshte marre per shkak se per kete eshte administratorja E..

Kur eshte intervistuar nga Birn lenda ka qene ne gjykat dhe e ka kerkuar nga gjykata, duke e autorizuar administratoren qe ta kerkoj lenden.

I akuzuari A. A. ne mbrojtjen e tij ka deklaruar se me te demtuaren XH. ka jetuar ne bashkesi martesore 10 vite. Nga kjo martes kane ... femij dhe deri ne vitin 2012 nuk kane pasur probleme.

E ka pranuar se me ish bashkortin e tij, tani te demtuaren XH. K. ka patur disa probleme-mosmarveshje bashkshortore dhe gjithashtu edhe me anetaret e familjes se tani te demtuares. Sms-te per te cilat po behet fjala i ka kerkuar nga Sh. B. personalisht, por edhe perms mbrojtjesit te tij T. B., po e njejta nuk ka pranuar qe tua dorezoj. Keta sms i ka kerkuar per ti derguar familjes se ish bashkshortes , per me vertetu qe ka pas telashe me te.

Mesazhet i ka marre nga avokati G. B. dhe keto mesazhe i'a ka derguar vellaut dhe axes se ish bashkshortes R. dhe P. K., ka njohuri se ata i kane marre.

Ata i kane thene se nese eshte e vertet, ne te kerkojm falje dhe ta kena nje martes borgj, ne te kunderten na i ke dy gjaqe borxh.

Nuk e ka dite se është veper penale dergimi i mesazheve.

Me tani te demtuaren nuk jetojn ne bashkesi martesore, eshte i martuar me nje grua tjetere.

Nuk i kujtohet sakt se kur i ka marr tabulatet nga avokati G. B. . Pas pranimit te ketyre tabulateve, pas dy jave i ka derguar ne Z.. E ka dite qe nuk ben me i shpernda keto tabulate mirpo ka qene i kercenuar. Per nxjerrenj e ketyre tabulateve ky e ka kompenzu avokatin G. B. 250 (dyqind e pesedhjet) euro.



Avokati G. B. nuk i ka treguar se nga kush i ka siguruar tabulatet-sms dhe as nuk e ka pyetur ate.

Ne seancen e dates 16.06.2016, perfaqesuesi I te demtuares av. N. D. nga Gj. i ka propozu gjykates qe ne cilesi te deshmitareve te ndegjohen R. dhe A. K. nga fshati R., K. Gj. .

Me aktvendim procedural trupi gjykues e ka refuzu propozimin e perfaqesuesit te demtuares, me arsyetim, se keta deshmitare nuk jane te rendesishem sa i perket vertetimit te gjendjes faktike, per shkak se fjala eshte per R. K. i cili I ka pranuar tabulatet-sms, ne Z. nepermjet postes, te derguara nga tani i akuzuari A. A.. Ky fakt nuk eshte fare kontestues, sepse kete e ka pranuar edhe vet tani i akuzuari A. A., se u'a ka derguar ne Z. R. dhe P. K. . Nga ana tjetere gjat kundershimit te propozimit per degjimin e ketyre deshmitarve, e akuzuara Sh. B.e ka mohuar kategorikisht qe eshte takuar ndonjhere me keta persona.

**Ne fjalen perfundimtare**, te cilin e ka paraqitur me shkrim, prokurori i shtetit ka pohuar se eshte vertetuar se ne rastin konkret e njejta me dije – me dashje i ka vene ne dispozicion personit tjetere- informaten , qe me kete rast ka te beje me fshehtesi zyrtare me qellim te publikimit apo shfrytezimit te informacionit jashte Repbulikes se Kosoves. Ne rastin konkret tabulatet-sms, duke ia dhene G. B., e me pastaj i njejti ia dorezon personit te pa autorizuar tani te pandehurit A. A..

Duke i analizuar te gjitha keto te dhena qart verehet se te pandehurit Sh. B. dhe A. A. i kane kryer veprat penale qe u vihen ne barre kete e deshmojn N. LL., S. G., P. K., ne deklarata e tyra ne prokurori , duke shtuar pergjigjese per rastin PPN.nr. .../2012 ka qene vet e pandehura Sh. B. e cila e ka pas lenden , eshte marre me te , dhe te njejtat kane deklaruar se asnjeher dhe asnje shkres nuk ndodh qe pranohet pa u protokolluar.

Mbrojtja e te pandehures Sh. B. eshte kontradiktore.

Në fund ka kërkuar që ti shpall fajtor dhe ti ndeshkoj ne baze të kodit.

Perfaqesuesi i të demtuares, av N. D., në fjalen përfundimtare të cilin e ka paraqitur me shkrim, ne fillim të saj ka përshkruar të drejtën për kerkesë pasurore juridike të të dëmtuarës.

Pastaj e ka pershkrur rrjedhjen e procedures, duke thene se është përcjell me parregullsi të shumta.

Ka shprehur shqetësimin se edhe më pare e ka ditur se si do te vendoset kjo qështje penale dhe për këtë arsye kanë reaguar me shkrim duke deklaruar se Sh. B. do te lirohet, ndërsa do ta shpallni fajtor A. A. i cili sipas mendimit të tij me se paku është fajtor .

Është pajtuar në tërsi me analizat dhe vlerësimet e prokurorit, duke qenë i bindur se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që u vihen në barre.

Mbrojtja e të akuzuarës Sh. B. Prof.Dr.sc.av. Sh. P., specialist i deges penale, ne fjalen përfundimtare të cilën gjithashtu e ka paraqitur me shkrim, e ka përshkruar këtë proces gjyqësor si të drejte.

Mbrojtja ka konsideruar se aktakuza në pjesen e përshkrimit faktik por edhe në atë të cilësimit juridik është e pa bazuar dhe si e tillë e paqëndrueshme. Kjo aktakuz nuk ka mbështetje në provat e nxjerrura gjate prodeures së zhvilluar dhe si e tillë është e paqëndrueshme.

Me asnjë prove gjatë procedures se zhvilluar nuk është argumentuar se e njëjta si person zyrtar, pa autorizim të këtë kumtuar , të këtë dërguar ose në ndonje mënyr tjetër të këtë vënë në dispozicion personit tjetër, informacionin i cili në përmbajtjen e tij trajtohet si fshehtësi zyrtare.

Nuk është kontestuese fakti se Sh. B. e ka pasur në punë lenden PPN.nr. .../2012, e ka punuar atë dhe pas përfundimit e ka deponuar lenden ne shkrimore me datën ... .2012 dhe këtë qeshtje me atë date e tutje ka qenë e mbyllur ndërsa Sh. B. nuk është marrë me te.

Pozicionin qëndror në këtë qështje penale e mban G. B. avokat nga P. .

Nga deponimet e dhëna të dëshmitarëve apsolutikisht nuk është konfirmuar në asnjë mënyre se këto tabulate janë marrë nga e mbrojtura e tij Sh. B. ndërsa aktakuza e prokuroris mbështetet ne supozime vetem duke pas parasysh se e njëjta ka pas ne pune këtë lënd.

Edhe dëshmitari G. B. asnjëherë nuk ka deklaruar se tabulatet i'a ka dhene Sh. B. .

Nga dëshmia e dëshmitarit K. G., i cili ka thënë se gjate intervistimit të të dëmtuarit A. , i cili ka pohuar se tabulatet i 'a ka siguruar avokati G. B. tek kryerprokurorja Sh. B. dhe për këtë ka paguar 250.00 (dyqind e pesedhjet) euro. Mirpo në shqyrtimin gjyqësor me shtjellimin e provave dhe atë dy CD-ve nga përmbajtja e tyre gjate intervistës së dhëna të tani te akuzuarit A. i njëjti decidivisht thote se tabulatet i'a ka siguruar G. B., ndërsa fare nuk përmendet emri i të akuzuaraes Sh. B. .

Nga te cekurat me larte pa kurrfar dyshimi mund te konkludohet se ne rastin konkret , nuk është provuar me asnjë prove të vetme se e akuzuara Sh. B. të ketë kryer veprat penale për te cilat është akuzuar, për këte arsye ka propozu gjykatës aktgjykim lirues (Liberato)

E akuzuara Sh. B. e ka mbeshtetur në tërsi fjalën e mbrojtjesit të saj pa asnje ndryshim.

Ne fjalen përfundimtare gjitashu të paraqitur me shkrim nga ana e mbrojtësit të akuzuarit A. A. av. S. R., në fillim të fjales përfundimtare i ka përshkruar raportet ndërmjet të mbrojturit të tij A. A. dhe tani të dëmtuaes XH. K., duke theksuar se A. ka pasur kërcënime nga familjarët e të dëmtuaes dhe ka qenë i detyruar që këta sms ti'a deshmoj.

Nuk është kontestues fakti se A. tabulatet e sms-ve i ka siguraur nga av. G. B., gje qe edhe vet e ka pranuar..

Nga te cekurat më lart dhe pasi ka kaluar afati i parashkrimit, i ka propozu trupit gjykues që lidhur me këtë qështje penale të merret aktgjykim refuzues.

I akuzuari A. A. e ka mbështetur në tërsi fjalën e mbrojtësit te tij pa asnje ndryshim.

**Pas përfundimit të séances gjyqësore me date 16.06.2016**, për shkak të problemëve teknike me kompjuter, sekretarja juridike nuk ka mundur menjëher që ta nxjerr kopjen e procesverbalit, dhe është kërkuar nga palët që të presin për nënshkrim të procesverbalit, por këtë kërkes të gjykatës nuk e kan përfill e dëmtuara XH. K. dhe avokati i saj N. D., meqë rast janë larguar nga gjykata pa e nënshkruar procesverbalin.

**Për këtë arsye gjykata në fund të procesverbalit ka përpilu një konstatim, te cilin e kan nenshkuar Kryetari I trupit gjykues, anetaret e trupi dhe Sekretarja Juridike.**

Gjykata ka analizuar me kujdes aktakuzen e Prokurorise, te gjitha provat e administruara, mbrojtjen e te akuzuarve dhe ka konstatuar:

Nuk eshte kontestuese, qe e akuzuara Sh. B. ne cilsine e Prokurores se Prokuroris Komunale ne Gjakove ne vitin 2012, e ka patur ne pune lenden PPN. .../2012, ku si I demtuar ishte paraqitur tani I akuzuari A. A., per shkak te nji kanosje gjeja nga te afermit e tani te demtuaraes XH. K..

Gjithashtu nuk eshte kontestues fakti, se Prokurorja Sh. B. kishte ndermarre veprime hetimore ne drejtim te zbardhjes se te vertetes lidhur me kete pretendim te atehere te demtuarit A. A. per kanosje, duke urdhruar pergjimin e telefinit celular me nr. ..., nga I cili ishte pretenduar se ishin ardhur ato kercnime per te demtuarin (tani te akuzuarin) A. A.. Pas pergjimit te ketij telefoni, ishin nxjerre tabulatet e SMS-se dhe pasi kishte ardhur ne perfundim se rasti nuk ka te beje fare me kanosje, Prokurorja Sh. B. e kishte hudhur Padin penale te te demtuarit A. A., me arsyetim se nuk kemi te bejme me elemente te kanosjes, qe

vertetohet nga Aktvendimi I Prokuroris Komunale te Gjakoves PP.nr. .../2012 te dates ... , I nenshkruar nga Prokurorja Sh. B. .

Per kete gje Prokurorja Sh. B. e kishte njoftuar edhe te demtuarin A. A., qe vertetohet me njoftimin e dates ... .2012.

Prokuroja Sh. B. kete lende e kishte perfunduar, duke e konsideruar si te kryer dhe **e cila duhet te arhivohet**, qe vertetohet me shenimin zyrtar te dates ... .2012, PPN.nr. .../2012.

Gjykata me asnji prove te vetme nuk ka mundur ta vertetoi faktin se tabulatet e SMS-ve, te nxjerrura gjat procedures hetimore ne Prokurin Komunale te Gjakoves te ken dale ne opinjon nga tani e akuzuara Sh. B. .

Nese I referohemi deklarave te deshmitareve te prokurorise dhe ate: E. T., S. G., N. Ll. dhe P. K., ne asnji rast nuk kan deklaruar dhe nuk kan asnji dieni, se Sh. B. t'ia kete dhene dikujt keto Tabulate te SMS-se, bile ato ne deklarat e tyre, pothuaj se identike, kan deklaruar se per rastin konkret kan ndegjuar nga mediat dhe tek atehere kan marre vesh se lenda per te cilen po behet fjal, ka qen ne pune te Prokurorja Sh. B. cka do te thot se ato deri atehere nuk kan dite fare per keto Tabulate te SMS-ve.

Edhe deshmitari T. B., I cili ka qen perfaqses I tani te akuzuarit A. A. ne nji procedure kontestimore, lidhur me shkurorzim dhe besim te femijve, ka deklaruar shprehimisht, se Tabulatet e SMS-ve I ka pranuar nga tani I akuzuari A. A., I cili I kishte deklaruar se I kishte siguruar nga Av. G. B. dhe per kete kishte paguar 300 euro, I cili e kishte perfaqsuar A. ne procedure penale, por qe nuk I ka treguar se prej kujt I ka marre. Ne kete rast, ne sanji menyre nuk eshte permendur se ka qen e involvuar tani e akuzuara Sh. B. .

Nese I referohemi deklarates se deshmitarit K. G., gazetar I BIRN, I cili ka deklaruar se ne intervisten e dhene per BIRN, A. A. kishte deklaruar se Tabulatet e SMS-ve I ka siguruar Av. G. B., tek Kryeprokurorja Sh. B. dhe per keto ka paguar shumen prej 250 euro.

Gjykata ne séance gjyqsore ka reprodukuar-ka ndegjuar intervisten e A. A. dhene BIRN, ku I njejeti kishte deklaruar se Tabulatet e SMS-ve, I kishte kerkuar nga Prokurorja Sh. B. por e njejta nuk ia kishte dhene, por e njejta nuk ka pranuar qe te ia jep. Pastaj I eshte drejtuar Prokurorit te Shtetit, por se I njejeti me nji pergjigje ka thene se mesazhet nuk mundem me I marre.

Me tutje ne kete interviste A. A. ka thene, se mesazhet I ka nxjerre nga Av. G. B., sepse T. B. nuk I jan dhene.

Pra ne kete rast, gjykata nuk ka mundur ta vertetoi ate cka ka deklaruar deshmitari K. G., se "A. I paska thene ne kete intervist, se Tabulatet e SMS-ve, I paska suguru nga Av.G. B., tek Kryeprokurorja Sh. B.". Pra te fjalia mesazhet e siguruara nga Av. G. B. fare nuk eshte permendur ... Sh. B. qe eshte konstatu nga reprodukimi I CD-ve te BIRN, ne séance gjyqsore, e te cilat jan konstatuar ne procesverbal.

Pra si perfundim, ne rastin e te akuzuares Sh. B. me asnji prove nuk eshte vertetu, se e njejat I ka kryer veprat penale te cilat I vehen ne barre, andaj per kete arsye gjykata shpalli **Aktgjykim lirues per te akuzuaren Sh. B. .**

Nese I referohemi Aktakuzes se PTH-DKR ne Gjilan, Sh. B. eshte akzuar per tri vepra penale, zbulim I fshehtsise zyrtare nga neni 347 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, vepren penale Shperdorim I pozites zyrtare ose I autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 dhe vepren

penale cenim I fshehtsise se korrespondences dhe bazave te te dhenave kompjuterike nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 e 1 te KPRK-se.

Kur t'I referohemi veprimeve per te cilat ka pretend Prokuria se I ka kryer Sh. B. fjala eshte per nxjerrjen ne opinjon te Tabulateve-SMS-ve, per te cilat u be fjale me larte, na del se per ato veprime ka mundur Sh. B. te akuzohet per vepren nga neni 347 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te KPPK-se, sepse kjo veper penale I dedikohet kryekput personave zyrtar, te cilet pa autorizim kumton, dergon, ose ne ndonji menyre tjeter i ve ne dispozicion personit tjeter informacionin I cili perben nji fshehtsi zyrtare ose siguron informacionin e tille me qellim te percjelljes te nji person I pa autorizuar, apo e dergon ate jasht Kosoves.

Sa I perket vepres se dyte shperdorim I pozites zyrtare apo autorizimit nga neni 339 paragrafi 1, kjo veper penale nuk perkon me veprimet, qe pretendon Prokuroria se I ka kryer Sh. B. munde te jet ose e para ose e dyta, e jo per te njejtat veprime te akuzohet per dy vepra penale te ndryshme.

Nga ana tjeter kemi edhe parashkrim relative te ndjekjes penale, per vepren e penale nga neni 339 paragrafi 1 te KPRK-se, per shkak se denimi maksimal qe munde te jepet per kete veper eshte nji vit burg.

Afati I parashkrimit relative per kete veper eshte 2 vjet, kur te kihet parasysh se Sh. B. akuzohet se e ka kryer vepren penale ne ... 2012, ndersa kallximi penal eshte paraqitur nga e demtuara XH. K. me 16.10.2014, ndersa Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve eshte marre me date 10.11.2014 nga PTH ne Gjilan, cka do te thot se ende pa arritur lenda ne Prokurori kan kaluar me teper se dy vite, nga koha kur pretendohet se eshte kryer kjo veper penale, e conform nenit 90 paragrafi 1 nenparagrafi 6 te KPRK-se.

Parshkrimi absolut i ndjekjes penale te kjo veper, eshte me 1.korrik 2016.

Sa I perket vepres se trete penale per te cilen akuzohet Sh. B. cenim I fshehtsise se korrespondences dhe bazave kompjuterike nga neni 168 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 3 e 1 te KPRK-se, kjo veper penale nuk ka te beje fare me veprimet qe ka pretendu Prokuroria, se I ka kryer Sh. B. e as me natyren e punes se saje, pa u leshuar ne detale te metutjeshme se kush munde ta kryej kete veper penale.

Kur eshte fjala per te akuzuarin e dyte A. A., nuk eshte kontestues fakti se I njejt ka qen ne raporte bashkshortore me tani te demtuaren XH. K., dhe pas disa problemeve ndermjet tyre, ata jan ndare, e pastaj edhe jan shkuroruar. Pastaj I njejt kishte paraqitur nji kallxim penal ne ish Prokurorin Komunale ne Gjakove ne vitin 2012, per nji kercnim gjoja nga familjaret e te demtuares XH. K.. Ne kete procedure ne Prokurori ishte urdhruar pergjimi telefonit ..., nga Prokurorja Sh. B. dhe nga ky pergjim ishin dorzu ne Prokurori Tabulatet-SMS-ve, jo kontestuese ndermjet paleve.

Keto Tabulate te SMS-ve, tani I akuzuari A. A. I kishte siguruar nga Avokati I tij qe e kishte perfaqshuar ne procedure penale ne prokurori, Av. G. B. per te cilat kishte paguar 250 euro, dhe se keto Tabulate te SMS-ve I njejt ua kishte derguar dy familjareve te te damtuares XH. K. ne Z., R. dhe P. K., kete e ka pranuar vet I akuzuari A. ne mbrojtjen e tij te dhene ne kete gjykate, duke shtuar se e ka dit qe nuk bene me I shpernda, por se ka qen I detyruar per shkak te kercnimeve qe I jan bere nga familjaret e te demtuares.

Duke marre parasysh, se te gjitha veprimet jan kryer gjat muajit qershor 2012, jan siguru tabulatet-SMS-te nga A. A. dhe jan derguar brenda 2 javeve ne Z. te familjaret e te demtuares, e jo sikurse e pershkrun Prokuroria ne dispozitivin IV. te aktakuzes, ku pershkruhet vepra penale per A. A., ne te cilen thuhet se nga muaji ... 2012 e deri me ...

2014, me dashje ka cenuar fshehtsin e te dhenave te dokumenatve, pa paraqitur asnji prove te vetme per kete periudhe kohore.

Pra si kohe e kryerjes se vepres penale qe pretendon Prokuroria, duhet te jete ... 2012, ku nga ajo kohe e deri ne paraqitjen e kallximit penale nga ana e te demtuares me date ...2014 dhe Aktvednimit mbi fillimin e hetimeve PPSH/Inr. .../2014 me date .. .2014, te leshuar nga PTH ne Gjilan, kan kaluar me teper se dy vite, kohe e mjaftueshme per parashkrimin relative te ndjekjes penale, sepse per vepren penale nga neni 168 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 te KPK-se, denimi maksimal eshte nji vit burg, e conform nenit 90 paragrafi 1 e nenparagrafi 6 te KPK-se.

Per kete arsye u vendos si ne dispozitivin 2 te ketij aktgjykimi, duke e refuzuar akuzen e Prokurorise.

Parashkrimi absolut I ndjekjes penale per kete veper hyn ne fuqi me 1 korrik 2016.

Sa I perket deshmitarit G. B., nga dexhimi I tij, po thuj se fare nuk eshte nxjerre asgje, per shkak te pozites se tij si deshmitar I privilegjuar dhe ndalimit nga trupi gjykues, qe te pergjigjet ne disa pyetje te parashtruara nga palet.

**Provat tjera material siq jan:** kerkesa per njoftim nga XH. K. drejtuar Sh. B.e dates 7.10.2014, parashtrera e dates 08.11.2014 nga e demtuara XH. K. drejtuar Prokuroris Themelore ne Gjilan-DKR, kundershimi I dates 31.12.2012, kunder aktvendimit te Gjykates Komunale ne Gjakove E.nr.1087/12 I dates 12.12.2012 I parashtruar nga I pandehuri A. A., si dhe regjistri SEK I vitit 2012 I ish Prokuroris Komunale ne Gjakove, gjykata I ka konsideruar si te pa rendsishme per vertetimin e gjendjes faktike per kete qeshtje penale.

E demtuara XH. K., per realizimin e kerkeses pasurore juridike, eshte udhezuar ne contest civil.

Shpenzimet e procedures lidhru me kete lende mbesin ne barre te mjeteve buxhetore te Kshillit Gjyqsor te Republikes se Kosoves.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN  
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA  
Me dt, 20.06.2016**

**Sekretare Jurdike,  
Zahide Rexhepi**

**Kryetari i trupit:  
Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.